



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN
DALLIU, NR.59, NR.11
TEL: 672530602

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 1976

Tirane më 15/06/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021051000143215144

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ALBANA XH. SPAHIU



DATE 15/06/2021
NR REP 1976



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot me date 15 Qershor 2021 (dy mije e njezete e nje), para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, u paraqit personalisht:

Z. Josif GJEÇI, shtetas shqiptar, i biri i Maksim-it, lindur në datë 21/04/1986 ne Lushnje, banues ne Lushnje, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim nr. 033626007 dhe me nr. personal I60421130U.

Pasi verifikova dokumentacionin dhe gjeneralitetet dhe konstatova se jane ne perputhje me ligjin. Personi i paraqitur ne kete Zyre Noterie, **Z. Josif GJEÇI**, deklaroi se ka hartuar jashte kesaj Zyre Noterie **Akt Themelimi & Statut** të Shoqerise "**XHOSA ENERGY**" shpk.

Akti Themelimi & Statuti perbehet nga 23 Nene dhe 7 faqe dhe eshte i printuar ne 2 kopje te barasvlefshme, kopje te cilat u kontrolluan per ekuivalencen nga Une Noterja.

Personi i paraqitur ne kete Zyre Noterie, **Z. Josif GJEÇI**, me vullnetin e tij te lire, **nenshkruan ne pranine e Noteres**, Akt Themelimi & Statut të Shoqerise "**XHOSA ENERGY**" shpk, bashkangjitur ketij Vertetim Nenshkrimi. Gjithashtu **Z. Josif GJEÇI**, deklaroi se ka autorizuar **Z. Dylejman Karaj** te kryeje prane QKR, veprimet per regjistrimi, e shoqeris ee Regjistriun Tregtar

Une noterja vertetoj rregullsine e nenshkrimimit Akt Themelimi & Statut të Shoqerise "**XHOSA ENERGY**" shpk, ne baze te neni 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë".

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të personave të paraqitur në Zyrën time Noteriale, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NENSHKRUESI

NOTERE

ALBANA XH. SPAHIU

Josif Gjeçi



Albana Spahi



AKT THEMELIMI & STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

"XHOSA ENERGY" shpk

Sot ne date 15 qershor 2021, Une **Josif GJECI**, shtetas shqiptar, i biri i Maksim-it, lindur në datë 21/04/1986 ne Lushnje, banues ne Lushnje, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Leternjoftim nr. 033626007 dhe me nr. personal I60421130U,

me cilësinë e "Ortakut të Vetëm Themelues",

me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë dhe me inisiativën e lirë private, mbështetur në:

- "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë";

- "Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

- "Ligji Nr. 9723 dt. 03/05/2007 "Për Qëndren Kombëtare të Rregjistrimit";

- "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë";

Vendosa te hartoj kete Akti Themelimi & Statut per shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "**XHOSA ENERGY**" shpk, e cila ka formën e nje shoqërie me pergjési te kufizuar (sh.p.k) qe do te funksionojë ne përputhje me ligjin Shqiptar dhe statutin e saj, si me poshtë:

Neni 1 - Krijimi

Shoqëria "**XHOSA ENERGY**" shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2 - Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**XHOSA ENERGY**" shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Emri i shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë.

Neni 3 - Selia dhe Territori

Shoqëria "**XHOSA ENERGY**" shpk do të ketë selinë në: **Lagjja "Çlirimi" rruga " Uan Kondakçiu" Godina 3 katëshe, përberi lokal "Pilo Lala", Lushnjë, (Shqiperi), Kontakt Z. Josif Gjeçi Nr. cel 0682080141, e-mail: josif.gjeci123@gmail.com.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Mbledhjes së Asamblese se Ortakeve.

Neni 4 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- **Ndertimi, montimi, prodhimi, si dhe shitblerja e energji se rinovueshme (Fotovoltaik) tek subjektet private apo shtetore te cdo lloj kategorie si dhe tek OSHE;**

- **Shitblerjen** e elementeve qe duhen per ndertimin e centraleve me energji diellore (**Fotovoltaik**);

Neni – 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë per nje periudhe te pacaktuar, duke filluar ky afat qe nga moment i regjistrimit ne QKB;

Neni – 6 Filiali dhe zyrat e përfaqësues

Shoqëria “ **XHOSA ENERGY** “ sh.p.k, mund të ketë filiale te saj ose zyra përfaqësie në te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe ne cdo tjetër te huaj;

NENI – 7 Përgjegjjesi e Ortakut te vetem

Ortaku nuk përgjigjet personalisht për detyrimet e Shoqërisë; .

Ai përgjigjet për humbjet e Shoqërisë, aq sa është pjesa e kuotës së paguar prej Tij;

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI – 8 Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është **10,000 Lek (dhjete mije Lek)** i investuar nga Ortaku i vetem **Josif Gjeçi** ;

8.2 Ortaku ka kontribuar në themelimin e Shoqërisë dhe posedon kuotat në proporcion si më poshtë:

1. Ortaku Josif Gjeçi i datelindjes 1986, identifikuar me kartën e identitetit me numer I60421130U i cili posedon 1 (një) kuotë të kapitalit të Shoqërisë me vlerë **10,000 Leke (ALL)** qe përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % të kapitalit të Shoqërisë;

NENI – 9 Zmadhimi i kapitalit

9.1. Kapitali i Shoqërisë mund te zmadhohet pa limit, ne një ose më shumë herë me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme ;

9.2. Në rast të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, ortakut ka të drejtë të nënshkruajë dhe paguajë pjesën e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesën e vet të pjesëmarrjes në kapitalin social të Shoqërisë;

NENI – 10 Zvogëlimi i kapitalit

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

10.2 Në cdo rast, kapitali i regjistruar i Shoqërisë nuk mund të ulet nën limitin dysHEME të vendosur me ligj;

10.3 Zvogëlimi i kapitalit social e prek ortakun në proporcion me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e Shoqërisë, përvec rastit kur Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë ndryshe;

NENI – 11 Transferimi i kapitalit

11.1 Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund t’ju kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht;

11.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund t’ju kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht personave të tretë , jashtë kësaj Shoqërie, por duke respektuar këto klauzola:

-Ortaku ka të drejtën e parablerjes për kuotat që dëshiron të trasferojë/kaloje;

-Ortaku ka të drejtën e parablerjes së kuotave me të njëjtat kushte dhe të njëjtin cmim me të cilin Ortaku mund të t'ja shiste një personi të tretë kuotën e tij;

11.3. Brenda 30 dhjetë ditëve nga momenti i komunikimit, Ortaku duhet të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes, në rast të kundërt, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga keto kuota;

11.4. Në rast se Ortaku dëshiron të shesë kuotat e tij, mund t'ja kalojë një personi të jashtëm nga Shoqëria me kushte më të favorshme në krahasim me ato të ofruara nga ortake të tjere, në lidhje me të drejtën e parablerjes nga ana e tyre;

11.5. Atehere kontrata për kalimin e kuotave që do të nënshkruhet me personin e tretë, nuk do të jetë e vlefshme, Shoqëria dhe oraktët nuk do të japin miratimin për këtë kalim;

11.6. Të gjitha komunikimet do të bëhen me shkrim dhe me postë rekomande me lajmërimim marrje;

11.7. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Bashkeshorti, para-ardhesit dhe pas-ardhesit mund të behen ortake, nepermjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

11.8. Kuotat janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet para-ardhësve dhe pas-ardhësve.

11.9. Kuotat e kapitalit mund të transferohen në mënyrë të lirë përmes dhurimit (falas).

11.10. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

Klauzolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes në kohë dhe sipas kushteve të parashikuara për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese së Ortakeve që vendos për pranimin e transferimit të një personi të tretë.

Ortakët mblihen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nepermjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën "pro" (në favor) me të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

Pëlqimi mund të refuzohet vetëm kur bleresi nuk jep garanci të mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive ose për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo të ortakevete të tjerë.

Asambleja e Ortakeve duhet të njoftojë, me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim, ortakët kërkesë që nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhënë dhe Ortaku mund të transferojë kuotën e tij.

Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

NENI – 12 KONFIDENCIALITETI

-Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

DOKUMENTAT E DESTINUARA PËR TË TRETËT

-Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj, duhet të tregojnë lexueshem emrin e shoqërisë dhe pas tij

incialet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "shpk", si dhe emrin e administratorit ose të administratorëve.

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI – 13 ORGANI VENDIMMARRES

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i Shoqërisë. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do t'i referohet termi Asamble e Ortakëve.

Shoqëria do të drejtohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë. Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakeve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

NENI – 14 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESE

Asambleja është organi i vetëm vendimmarres i Shoqërisë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- i) largimin dhe përjashtimin e ortakut;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

NENI – 15 MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

15.1. Asambleja e Përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga ligji ose në statuti, sa herë që do të konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;

15.2. Asambleja duhet të thërret në paktën një herë në vit;

15.3. Asambleja e Përgjithshme thirret sipas parashikimeve të nenit 83 dhe 84 të ligjit nr.9901, datë 15.01.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" në Republikën e Shqipërisë;

15.4. Ortaku do të njoftohet nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike;

15.5. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës si dhe t'ju dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

15.6. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas këtyre rregullave dhe sipas këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë;

15.7. Mbledhja e përgjithshme e Asamblesë mund të mbahet në selinë qendrore të Shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar.

NENI – 16 PJESEMARRJA NE VENDIME

16.1. Ortaku ka të drejtën e votes, në proporcion me pjesëmarrjen e tij në kapitalin social;

16.2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble nga një person i tretë në bazë të një autorizimi të leshuar prej tij. Ky autorizim mund të lëshohet për një mbledhje të vetme, ose më me shumë mbledhje;

NENI – 17 PROCESVERBALI I MBLEDHJES

17.1. Të gjitha vendimet e mbledhjes do të regjistrohen në një procesverbal. Procesverbali duhet të përcaktojë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e presidentit të mbledhjes, emrin e sekretarit të mbledhjes dhe rezultatin e votimit;

17.2. Presidenti i mbledhjes përcakton kush do të jetë sekretari për redaktimin e procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak në Shoqëri. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga presidenti dhe nga sekretari;

17.3. Procesverbalit i bashkëlidhen emrat e personave prezent dhe njoftimi për thërritjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme;

ADMINISTRATORI

NENI – 18 ADMINISTRATORI ESHTË ORGANI EKZEKUTIV I SHOQERISE

18.1. Asambleja e Përgjithshme, emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë.

Ne rast se emërohet me shume se një administrator, ata e administrojnë shoqerine se bashku apo vec e vec.

Administrator i shoqerise per nje periudhe 5 (pese) vjeçare eshte **Z. Josif GJECL**. Administratori mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person me ane të një Prokure të Posacme ose Prokure të Përgjithshme, i cili mund të jete shtetas shqiptar apo i huaj.

18.2. Ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

18.3. Ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë tregtare përpara çdo institucioni publik ose privat.;

18.4. Ka të drejtë të përgatisë çdo lloj akti të nevojshëm për ecurinë e Shoqërisë dhe ta depozitojë atë, pranë çdo institucioni publik ose privat sipas ligjeve në fuqi;

18.5. Merret me menaxhimin e përditshëm të Shoqërisë duke kryer të gjitha aktivitetet e nevojshme si dhe mbikqyrjen e personelit;

- Kryen punësimet dhe pushimet nga puna;

- Përcakton udhëzimet për kryerjen e detyrave për aktivitetin e Shoqërisë;

- Mban korrespondencën e Shoqërisë;

- Autorizon blerjen, qirane e sendeve ose shërbimeve të nevojshme të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin tregtar të Shoqërisë;

-Autorizon kryerjen e transfertave bankare ose tërheqjen e shumave nga llogaritë rrjedhëse të Shoqërisë, në lidhje me pagesat e pagave ose shpërblimet e punonjësve të shoqërisë;

-Firmos faturat për shërbimet dhe veprimet që Shoqëria kryen;

-Kryen të gjitha veprimet e nevojshme, përsa i përket nënshkrimit të cdo pagese bankare, depozite, tërheqjet, derdhjet ose transfertat e ndryshme në llogarinë apo në të gjitha llogaritë e Shoqërisë, pranë cdo Banke, në të cilën llogaritë janë hapur;

-Përfaqëson Shoqërinë në lidhje me cdo kontratë ose marrëveshje me të tretët persona fizike apo juridike, vendas ose të huaj, me institucione, ose ente publike të cfarëdo lloji;

18.6. Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë që kalon tagrat e mësipërme, administratori duhet paraprakisht të ketë marrë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme;

18.7. Administratori i Shoqërisë do të jetë Ortaku i vetëm i saj zoti Josif Gjeçi i cili do të administrojë aktivitetet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.

EKSPERTI KONTABEL, VITI FINANCIAR, BILANCI DHE DESTINIMI I TE ARDHURAVE

NENI-19 VITI FINANCIAR DHE TE ARDHURAT

19.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor;

19.2. Bilanci vjetor, inventari, raporti mbi ecurinë e aktivitetit tregtar dhe raporti i ekspertit kontabel të autorizuar, aprovohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Bilanci dhe pasqyrat financiare për vitin financiar duhet të aprovohen brenda tre muajve nga përfundimi i vitit financiar;

NENI-20 SHPERNDARJA E TE ARDHURAVE

20.1. Të ardhurat i jepen Ortakut në proporcion me pjesëmarrjen dhe kuotat e Tij;

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

- Aktivitetet e Shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre.
- Shoqëria posedon aktive në likuiditete të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm;

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI – 21 MBYLLJA DHE LIKUIDIMI

21.1. Shoqëria shpërndahet ose priset në cdo kohë, në rastet e parashikuara nga ligji ose Asambleja e Përgjithshme:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblese;

c) me fillimin e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Në kete rast, Ortaku merr vendim me shkrim, në të cilin parashikohet menyra e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij, emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqëri në likuidim e siper”;

21.2. Prishja e Shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit për gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi;
21.3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku. Nëse Ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet Gjykatës, për të caktuar një likuidues;

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI – 22 MOSMARREVESHJET

22.1. Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të zgjidhen me mirekuptim, në rast se nuk arrihet një marrëveshje mirekuptuese, atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;

NENI – 23

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil si dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë;
Ky Statut dhe Akt - themelimi janë mbajtur në 4 kopje në gjuhë shqipe.

AUTORIZOHET Av. Dylejman Karaj, Anetar i Dhomes së Avokatise Tirane, me Liçensë Nr.4784, të paraqitet pranë QKB për të bërë regjistrimin e Shoqërisë në regjistrin Tregtar.

Ortaku Themelues

JOSIF GJEÇI

Josif Gjeçi
